

VENDIM
Nr. 30/2016

**PËR KRIJIMIN E NJË KOMISIONI HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË HETUAR
DHE VERIFIKUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJEN E
INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR GJATË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT
TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE NEGOCIMI I
MARRËVESHJES SË SHITJES SË AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10 116,
DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND
TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH)
SHA NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CEZ A.S.”, SI EDHE EVIDENTIMI I
EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E
ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit me objekt si më poshtë:

1. Hetimi dhe verifikimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe negocimi i Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”, evidentimi i efekteve negative financiare.

2. Hetimi dhe verifikimi i ndjekjes dhe zbatimit nga autoritetet publike të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”.

II. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

III. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësiwe institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e organeve përgjegjëse për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juridikë.

VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit

të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 14.4.2016